

INTERVISTË ME HALIT GASHIN

Prishtinë | Data: 28 qershor, 2019

Kohëzgjatja: 84 minuta

Të pranishëm:

1. Halit Gashi (I intervistuari)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Besarta Breznica (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Cilat janë kujtimet e juaja të fëmijërisë?

Halit Gashi: E kom pasë ni jetë, pak shumë dinamike dhe kështu që kujtimet e fëmijërisë ka pak janë zbehë. I kanë mujtë ngjarjet shumë të rëndësishme. Pastaj edhe ka pak edhe kujtimet e fëmijërisë zbehen. Por, ajo që më kujtohet prej fëmijërisë në Janjevë, një gjallëri shumë e madhe e njerëzve. Ka pasë shumë njerëz, ka pasë shumë biznese t'vogla. Secila familje e ka pasë ka ni biznes të vetin.

Në sistemin socialist, Janjeva ka lulëzuar në një sistem të imtë kapitalist. Janjevasit kanë qenë njerëz të zotë, që përkundër vendbanimit kodrinor-malor ia kanë dalë me jetu mirë në Janjevë. Me kto kushtet, pa tokë të punëshme, pa ndonjë veprimtari tjetër, por megjithatë janë kanë ato zejet e vogla që ka pak njerëzit i kanë nënçmu po kanë sjell të hyra për familjet janjevase.

Edhe kanë punu jashtë Janjevës shumë jashtë Janjevës, nëntë muj ditë. Tre muj ditë të hollat që i kanë fitu jashtë Janjevës i kanë shpenzu në Janjevë. E mira e së mirës është se të hollat që i kanë fitu jashtë Janjevës i kanë shpenzu në Janjevë. Numri i madh i nxanësve në shkollë, që është, ka pesë-gjashtë paralele për ni vit kanë qenë do të thotë...

Anita Susuri: Në cilën shkollë keni qenë ju?

Halit Gashi: E ka pasë emrin, para luftës, "Vladimir Nazor" e Janjevës. Tash, ne kur jemi nda prej sistemit, shkolla e ka marrë emrin "Shtjefan Gjeçovi", në të cilën shkollë edhe kom punu. Jom kanë sekretar njo nëntë vjet i shkollës. Tjetër...

Anita Susuri: Ishit duke tregu për klasat si kanë qenë.

Halit Gashi: Klasat kanë qenë me numër të madh të nxënësve edhe paralelet ka pesë ose gjashtë mrena ni viti. Domethanë, secili vit i ka pasë ka pesë deri në gjashtë paralele. Herë-herë ka ndodhë që ka punu shkolla me tri ndrrime se s'ka pasë kapacitet me i përballu të gjithë ata nxanës që kanë qenë. Sepse secila familje i ka pasë minimumi dhjetë fëmijë, minimumi ka qenë, e ma shumë. Prandaj, Janjeva ka pasë shumë banor deri në vitin 1989. Dikund me regjistrimin e fundit të popullsisë që ka

ndodhë në vitin, ku kemi marrë pjesë edhe ne shqiptarët, ka mrri numri i banorëve në gjashtë mijë banorë. E tash, kur është bo regjistrimi në 2012-ën Janjeva mezi i ka dy mijë banorë.

Anita Susuri: Me çka janë marrë prindërit e ju? Ju jeni, domethanë, ndër banorët më të vjetër të Janjevës. A ju kujtohet ajo jeta familjare?

Halit Gashi: Babën e kom pasë minator, nana ka qenë amvise. Na jem tetë fëmijë të një nane dhe të babës. Baba na ka rritë me rrogën e minatorit edhe e ka punu tokën. Kem pak tokë edhe tokën e ka punu. Do të thotë, jashtë punës që e ka pasë të rregullt, se ka udhëtu në kamë ni orë e dhjetë minuta për të shku me punu në Kishnicë, në minierën e Kishnicës, ai ia ka dalë me punu edhe tokën. Na ka shkollu neve të tetve me rrogën e minatorit.

Anita Susuri: A mundeni me na përshkru pak atmosferën në Janjevë si ka qenë aty në qendër në kohën kur ju keni qenë ma i vogël?

Halit Gashi: Unë e thashë me një fjalë që ka qenë një gjallëri e jashtëzakonshme. Ju i keni pa shtëpiat se si janë rrezbitë pa përkujdesje. Prej viteve të '90-ta ka fillu zbrazja e Janjevës. Nuk e kanë pa perspektivën. Në radhë të parë, mungesa e ujit i ka detyru njerëzit ndoshta edhe me lanë Janjevën krejt, këtë ambient të mirë që e ka Janjeva.

Po është karakteristike që është mungesë e ujit të pijshëm, ka mungesë të jashtëzakonshme. Nuk ia ka dalë as ai pushteti as kto pushtetet e tona nuk ia kena dalë që me krijue, që me pasë 24 orë, osht' për të ardhur keq, osht' për të ardhur keq në këtë shekull ne kemi reduktime deri në 20 orë. Qe pesë ditë nuk ka ardhë ujësjellsi në Janjevë, qajo ma e keqja. Qe pesë ditë nuk kemi fare ujësjellës edhe...

Prandaj, këto kushte, fillimisht këto kushte e kanë bo pastaj prej vitit '91 e ka bo edhe ardhja e Sheshelit. Dy herë ka ardhë në kamë në Janjevë edhe i ka kërcënu kroatët se do t'i, për ni sërë të vrarë në Kroaci do t'i vret njiqind kroatë në Janjevë. Ata janë detyru me u shpërngulë.

Anita Susuri: Para se të vazhdojmë ma tutje dashta me u kthy prapë pak ma herët. Domethanë, ju jetoni këtu në rrugën e "Sarajit".

Halit Gashi: Po.

Anita Susuri: Çfarë ka qenë ajo rrugë se njihet ajo rrugë?

Halit Gashi: Janjeva osht' ndër vendbanimet ma të vjetra që ka Kosova. Ka një histori të lashtë, jam duke grumbullu material edhe me dalë me një shkrim, nuk kam dalë ende. Unë jam njëri ndër themeluesit të takimeve... mbahen takimet të Shtjefën Gjeçovit në Janjevë. Prej vitit 2001 mbahen "Takimet e Gjeçovit". E njëri ndër themeluesit e atyre takimeve.

Në ato takime flitet shumë për historikun e Shtjefën Gjeçovit që ka lind në Janjevë, po pak ka jetu në Janjevë e pak flitet për Janjevën. Janjeva përmendet në shumë libra historik edhe në defteret e Perandorisë Osmane përmendet shumë, por edhe para deftereve të Perandorisë Osmane.

Ne u marrëm vesh që të tregojmë edhe anekdota. Amerikanët kanë investu në këtë rrugën, në qit' rrugën "Saraj", kanë investu në vitin 2002. Edhe në përrurimin e kësaj rruge e thashë një fjalë që e kishin pasë, kish pasë bo bujë ajo fjalë e imja se, "Kur Parisi dhe Londra kanë qenë për lloç, Janjeva ka pasë kalldrëm".

Janjeva e vjetër ka qenë pak ma naltë se që është vendbanimi i sotshëm. Mirëpo, në kohën e Perandorisë Osmane, qikjo lagje paska pasë shtëpia ma të bukura në krahasim me lagjet e tjera edhe tani për shkak se janë kanë ato saraje i ka mbetë emri rrugës "Saraj". Ne nuk ia kemi ndrru rrugës emrin "Saraj" edhe kur ka qenë pushteti komunist edhe pas luftës ia kemi lanë të njejtin emërtim. Nuk e kemi ndrru emërtimin. Kjo është zanafilla e toponimit ose emërtimit të kësaj rrugës ku banoj.

Anita Susuri: A mundeni me tregu edhe pak për ndikimin e kulturës turke në Janjevë? Domethanë, llojet e shtëpive, kalldrëmat.

Halit Gashi: Unë po përpiqen me iu dhanë juve të dhana të sakta, po nëse nuk ia qëlloj osht' krejt prej asaj që nuk e kemi hulumtu sa duhet, nuk e kemi hulumtu. Po hetohet, hetohet. Në shtëpiat e vjetra hetohet ndikimi i stilit turk të ndërtimit dhe shtëpive me, shtëpive me lloje të kuzhinave të posaçme, ndejës, kthimit nga lindja ku shtëpia...

Anita Susuri: A iu kujtohet, për shembull, shtëpia juje e vjetër?

Halit Gashi: Jo, nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet se baba e ka prishë shtëpinë kur une i kom pasë dy vjet edhe fatkeqësisht nuk kem fotografi të asaj shtëpie. Janë rrënu nja dy-tri shtëpia që janë kanë eksponatë e bash asaj që po flas une. Ni lloj i mallterit, si quhet ai mallter? Në atë kohë ka pasë mallter do të thotë. Janë ndërtu... edhe kullat janë ndërtu në kohën e Perandorisë Osmane, ndoshta edhe para Perandorisë Osmane. Osht' me ni lloj, si quhet ai material i mallterit, po nuk po më bjen, tash nuk po më kujtohet.

Osht' shumë me vlera Janjeva. Ka qenë ni iniciativë që të konservohet. Dikur Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës ka qenë një ide që të konservohet edhe të shpallet si një vendbanim muze. Po, u hoq dorë prej asaj initiative. Për çdo ditë e ma shumë po humbin gjurmët e vjetra, po humbin gjurmët e vjetra edhe prej keqpërdoruesve që për pak përfitime po e prishin ni artifakt që ka mujtë me qenë shumë i rëndësishëm.

Anita Susuri: Ktu afër është edhe Kulla e Sarajit apo? Kulla e Pashë Karadakut më duket. A keni kujtime rreth asaj kulle?

Halit Gashi: Unë, të them të drejtën, aty kam kalu për me shku në shkollë po ata kanë rru me nifarë xhelozie, nuk kanë leju me hy mrena, m'u dokë... kur ka qenë e banuar ajo kullë se si është dukë. Une

e kom pa vetëm masi që është braktisë edhe tani e kanë dëmtu ka pak. E kanë dëmtu ka pak, po ne sa here kemi kalu rreth asaj kulle na janë ngjallë disa kujtime të librave që i kemi lexue të bejetave të ndryshme që janë zhvillu nëpër ato kulla. Edhe... fatkeqësisht ajo është dashtë me u marrë nën mbrojtje të Ministrisë së Kulturës edhe në Institutin për Mbrojtjen e Trashëgimisë Kulturore, fatkeqësisht. Ndoshta edhe është në regjistrin e institutit për mbrojtjen e këtyre monumenteve, por ajo dita ditës po dëmtohet, po dëmtohet. Edhe ka pak, ndoshta interierin e kanë ndërtu mrena, mirëpo për jashta nuk ka ndryshu kurgjo hiç, ajo është prej ndërtimit qashtu.

Anita Susuri: Sa vite keni shku ktu në Janjevë në shkollë?

Halit Gashi: Po tetë vite, tetë vite. Prej klasës së parë deri në klasën e tetë. Edhe në vazhdën e saj, Janjeva njihet për zanatli edhe qarkullon ni anekdotë, qarkullon ni anekdotë se, thuhet, është bartë prej gojës në gojë, po të shkruame nuk ka kurgjo. Po, gjoja se kur paska ardhë Nastradini në Janjevë edhe i paska pytë janjevasit, vërtetë para se me i pytë çka po bojnë, ai qenka lavdua se e paska ni kopsht edhe laknat shumë të mdhaja që, “S’ka kacë që i nxen laknat e mia”.

Edhe tash, në vazhën e kësaj janjevasit e kanë mbajtë në mend çka ka thanë kur ka ardhë për herë të parë. Kur ka ardhë për herë të dytë ata t’u punu me çekana, t’u trokitë e ka pytë njanin, “Çka po punojnë kta?” “O janë tu e maru atë kacën e madhe për laknën tane”. Kështu që, ai kur e ka pa që... paska pasë nemë kisha, mos u bofsh as shehër as katun. E prej asaj neme na ka mbetë neve që s’jem as shehër as katun.

Anita Susuri: Janjeva gjithashtu njihet si vend që ka pasë shumë pemë, shumë lloje të pemëve, perimeve, a ju kujtohet kjo si ka qenë?

Halit Gashi: Dikun pas Luftës së Dytë Botërore, sipas asaj që une di, se gjyshin e kom pasë mjeshtër të hardhive. Gjitha qito kodra i mbaj në mend që janë kanë vreshta. Janë prishë hardhitë e rrushit po të gjitha këto kodra kanë qenë të mbjelluna me hardhi të rrushit edhe rrushi që osht’ prodhu, osht’ kultivu në Janjevë e ka pasë ni shije të jashtëzakonshme që nuk ke mujtë me gjetë në rreth ktu asi rrushi. Po prej viteve ‘85-‘86 e sidomos kur osht’ ndërtu tenda e Liqenit të Badovcit ka fillu me i dëmtu pemët edhe perimet e Janjevës.

Avullimi i ujit të Liqenit të Badovcit ka shkaktu shumë telashe në Janjevë. Prej asaj kohe ka fillu shumë me dëmtu pemtarinë e Janjevës. Osht’ e vërtetë që çdo lloj të frutave të mundshme që kanë ekzistu në Janjevë ke mujtë me i gjetë. Nuk ke mujtë me i gjetë askund në Kosovë. Po prej viteve të ‘90-ta e knej kanë hjekë dorë edhe shumë njerëzit, sidomos prej vreshtave. Dy-tri vneshta kanë mbetë prej të gjithë asaj. Veç prej kooperativës bujqësore kanë qenë dikund rreth 50 hektar vreshta, tash ato janë mbetë shkret. AKP-a ia ka shitë dikujt edhe e kanë ndryshu veprimtarinë.

Anita Susuri: Gjatë kohës që jeni rritë ju në Janjevë, cilat kanë qenë vendet ma interesante për juve?

Halit Gashi: Une, po iu thom se na kem pasë kinema në Janjevë. Djali jem që i ka 20 vjet nuk e din çka është kinemaja, ne jemi rritë me kinema. Do të thotë, unë nuk kom pasë mundësi me ia ofru atë kënaqësi që me shku me pa djali ni film apo ni shfaqje teatrale se s'ka pasë.

Anita Susuri: A iu kujtohet kur keni shku, për shembull?

Halit Gashi: Kur kom shku për herë të parë kom qenë nxans i klasës së dytë edhe emocionet po më doket sikur janë sot (qeshë). E vërtetë, shumë e vërtetë që u kanë tjetër ndjenjë. Tash, zhvillimi teknologjik e ka hupë atë ndjenjën me ditë çfarë filmi interesant ose me pa çfarë vendi interesant se osht' afu shumë bota.

P'e shohim në telefon krejt botën me sy edhe s'po na duket diçka interesant po atëherë zhvillimet kanë qenë pak më të ngadalshme edhe emocionet janë kanë ma të mdhaja. Për shkak të zhvillimeve të ngadalshme e spontane jena ka qenë ma spontane. Është folë, për shembull, për ni martesë, për ni ngjarje kulturore është folë dy-tri javë ditë derisa ka ndodhë. Tash, ni orë nuk flitet për ni ngjarje kulturore, për ni ngjarje sportive apo edhe për një dasëm.

Anita Susuri: Çfarë filma keni shiku?

Halit Gashi: Nuk kena pasë zgjedhje shumë. Çfarë na kanë pru prej Shtëpisë së Kulturës së Lipjanit me i shiqu. Përgjithësisht kanë qenë filma indian edhe Uka i Bjeshkëve të Nemuna filmi i parë shqip që e kena pa në kinema ka qenë Uka i Bjeshkëve të Nemuna. Faruk Begolli e ka lu rolin, njërin prej roleve kryesore. Ajo ishte kënaqësi e llojit të veçantë, Uka i Bjeshkëve të Nemuna.

Kur nesër ndëgjojshim në kinema se po flitet shqip ishte një lloj... nuk mundem me shpjegu qysh jemi ndje na kur për herë të parë u lshu ni film shqip në kinemanë tonë. Se, u lshu me titra e kena lexu po u shku serbisht i përkthynë. Po shqip, tant me ndëgju që po flet shqip u kanë Uka i Bjeshkëve të Nemuna.

Anita Susuri: Kush e ka frekuentu ma shumë këtë jetën kulturore shoqërore? A vetëm kroat kanë qenë ma shumë a edhe shqiptarë?

Halit Gashi: Në përgjithësi, kroatët kanë qenë ma të organizuar. Une po e them këtë, e kom thanë çdo kund, po e thom edhe në këtë intervistën me ju, fatkeqësisht ata nuk janë kroat. Ata janë shqiptarë të kroatizuar se nuk ka Mazrekiq mbiemer kroat. Ata kanë qenë Mazrekaj po ndikimi i kishës katolike kroate e ka bo të vetën. Me privilegje të ndryshme.

Gjithë qytetarët e Kosovës edhe të Maqedonisë edhe të Malit të Zi deri në '58-ën e kena pasë mbiemrin viç, me viç, për shembull, familja jem e ka pasë mbiemrin Aliu e kena pasë Alieviç deri në '58-ën. Përgjithësisht, krejt e kena pasë ka ni prapashtesë viç përmbra. Edhe, ata të besimit katolik e kanë pasë të gatshëm asimilimin. Edhe janë asimilë prej '58-ës e knej. Nuk ka pasë kroatë në Janjevë.

Kanë ardhë disa kroatë shëtitës në kohën e Republikës së Dubrovnikut edhe kanë mbetë, kanë mbetë në Janjevë. Po krejt kta janë shqiptarë. Se nuk njihet kurrë, familja kroate i ka pasë dymdhetë fmi, tremdhetë fmi, katërdhetë fmi. Këta krejt i kanë pasë ka katërdhetë fmi, pesëmdhetë fmi e gjashtëmdhetë fmi i kanë pasë...

Anita Susuri: Pse ka ndodhë ky asimilim?

Halit Gashi: Asimilimi për shkak të privilegjeve. Ju kanë dhënë privilegje shumë kisha katolike kroate edhe janë asimilu, janë asimilu. Për shembull, i kanë thanë vetës kroat, prindi i ka vdekë me plis të bardhë. Qeleshja e bardhë, plisi i bardhë nuk osht' relik, nuk osht' pjesë e kombit kroat, osht' e jona...

Anita Susuri: A ka pasë gjithmonë kisha ndikim te popullsia kroate edhe kur keni qenë ju ma i ri edhe...

Halit Gashi: Po, po, po. Vazhdimisht ka pasë. Vazhdimisht ka pasë edhe po vazhdon me pasë. Fatkeqësisht po vazhdon edhe me pasë po çka me bo. Njeri duhet me e deklaruar ata që e ndjen në vetëvete. A e ndin vetën kroat...

Anita Susuri: Thatë që tetë vite i keni kry në shkollë në Janjevë, pastaj çka ka ndodhë?

Halit Gashi: Unë, kom dashtë me shku... dëshira e prindit ka qenë une me u bo hoxhë edhe kom apliku në medresenë në shkollë të mesme, por nuk jom pranuar fatkeqësisht. Kanë ndodhë rrethana të tilla që jom vonu me apliku për hoxhë. Dëshira e rametlisë babës, ka qenë që unë... se kam qenë njëri prej nxansave t'mirë të Janjevës edhe dëshira e tij ka qenë që unë, jo të bohem hoxhë po ta kryj medresenë. Nuk ka qenë prej atyre që veç hoxhë me u bo. Ka pasë qëllime që unë me e marrë njohurinë për fenë e pastaj me u orientuar çka du me studiu. Ka pasë ide progresiste, ka jetuar pak, po ka pasë, e ka dashtë shkollën shumë. Shumë pak ka jetuar, po e ka dashtë shkollën. Une gati p'e boj moshën e tij kur ka vdekë ai. Pastaj, u regjistrua në shkollën e mesme. Në Lipjan e kam kry drejtimin juridik, ka qenë...

Anita Susuri: Para se të vazhdojmë, pasi u lidh me fenë, xhamia që është në Çarshi si, domethanë nuk ka emër po më duket...

Halit Gashi: Jo po, Xhamia e Murat Beut është.

Anita Susuri: Murat Beut. A keni kujtime rreth xhamisë?

Halit Gashi: Po, kom kujtime të mira për xhaminë gjithashtu jom kanë shumë i vogël kur baba m'ka marrë për herë të parë. Kur jom hi në xhami, ndoshta ndjenjën ma të fortë se sa të kinemasë. Ju pytët për kinema ma herët po unë po iu tregoj për ndjenjën që e kom pasë kur jom hi për herë të parë në xhami. Ajo ka qenë e rrezbitun edhe për disa vite edhe mbas luftës deri në 2014-ën kur pas shumë përpjekjeve e ka restauruar shoqata qeveritare turke TIKA. Ka bo ni investim të mirë edhe e ka restauruar objektin. Qiky objekti i parë që osht' ka qenë qashtu, po osht' restauruar. Bile minarja veç iu ka hjekë

lloçi i gurve ka pak. Minarja ka qenë qashtu qysh p’e shihni sot. Naltë do mermer ia kanë ngjitë se qysh p’e shihni qashtu ka qenë minarja, do të thotë afërsisht 200 vjet i ka xhamia e Janjevës që është ndërto, ndoshta edhe ma shumë se 200 vjet.

Anita Susuri: Si e kujtoni ju? Çfarë pamje ka pasë atëherë?

Halit Gashi: Po, filloi me u, pa mbikqyrje filloi pastaj me u rrezbitë ka pak e une nuk e mbaj në mend për të mira për pamjen e jashtme. Po, ajo që është mësu aty... une kom shumë kujtime të mira përmrena xhamisë e për pamjen e jashtme mirë që kanë intervenue.

Anita Susuri: Na tregoni pak për ato kujtimet nëse keni diçka?

Halit Gashi: Po përpiqem edhe pse ta thashë Anitë që kur...

Anita Susuri: A keni shku me shoqni? A keni pasë klasë që keni majtë me naj hoxhë?

Halit Gashi: Unë nuk kom shku me marrë mësim, po veç gjatë muajit ramazanit jom shku me babën me i fal taravitë edhe namazet e ndryshme. Shumë herët kom fillu me praktiku namazin, e praktikoj ende, vazhdoj me praktiku. Po, për shkak të ndalesave të ndryshme që u përpiqën me nda në mënyrë, me një vijë të fortë fejen prej shkollës... ka qenë e kufizuar edhe praktikimi i fesë.

Anita Susuri: Vitet e komunizmit?

Halit Gashi: Po, vitet e komunizmit ka qenë jashtëzakonisht i reduktuar edhe shfaqja publike e ndjenjave fetare. Osht’ dashtë pak me majt në veti jo me publiku. Fatmirësisht që tani po mundemi me e shprehë pa asni telashe.

Anita Susuri: A iu kujtohet Janjeva, deri në cilin vit afërsisht iu kujtohet që ka qenë e shtrume me kalldrëm? Qysh ka qenë ajo?

Halit Gashi: Jo, pjesën që ka qenë me kalldrëm e shtruar Janjeva nuk ekziston ajo Janjeva e vjetër. Duhet arkeologët me i zbulu. Ka një mori shpellash në Janjevë edhe që janë eksploatu xehet n’ta po ekziston edhe një anekdotë tjetër që as nuk e ka rrzu kërkush, po edhe me vërtetë s’e ka vërtetu. Thuhet se zagari t’u e ndjekë leprin kanë hi në Gadime kanë dalë në Janjevë. Shpella e Gadimes, janë disa gur të mermerit ku ka qenë ni gurëthyes i ngjashëm me gurët e Gadimës po m’u hulumtu s’osht’ hulumtu ende.

Anita Susuri: A i keni vizitu ndonjëherë ato vende?

Halit Gashi: Po, po, po, i kom vizitu. Bile mas luftës e pat’ zbulu ni qytetar i joni ni minierë që është shfrytëzu deri në vitet e vona para Luftës së Dytë, para Luftës së Parë Botërore. Aty jemi hi edhe kanë qenë njo dy-tri kronika në... po edhe në pjesën në hyrje të Janjevës quhet nifarë vendi Gradina, si fmi kemi lujtë shumë nëpër ato shpella. Ka pasë... po dikush thotë se mrena atyne gurëve ekziston ni

vendbanim ose ni kala që osht' shfrytëzu si pikë vrojtuese. Shihet krejt rrafshi prej asaj pike edhe ka qenë si pikë vrojtuese po ne nuk kemi mujtë me depërtu ose dikush ka mujtë me depërtu edhe i ka mbyllë qëllimisht a, po ka vend shumë për me u hulumtu Janjeva. Ka vend për me u hulumtu...

Anita Susuri: Për periudhën e shkollës së mesme ishit t'u na tregu. A ka qenë ajo hera e parë që keni udhëtu jashtë Janjevës?

Halit Gashi: Po, e vërtetë, e vërtetë. Une i kom pasë dajhtë qitu afër, kojshi. Qaty ku e parkova kerrin dajhtë e mi kanë qenë kshtu që nuk kom pasë shumë nevojë me dalë jashtë Janjevës. Fatkeqësia ka qenë që na nuk e kemi kry dy vitet... ka qenë kshtu sistemi i arsimit, dy vjet janë kanë të përgjithshme të paorientuar, kemi pasë landë të përgjithshme. Tani, dy vitet tjera i kemi pasë sikur prej klasës së dhjetë qitash që po orientohen. Ne e kemi pasë vitin e tretë edhe të katërtin. Viti i parë e i dyti kanë qenë të përgjithshëm të gjitha landë i kena pasë kurse i treti dhe i katërti... e qato dy vitet e para i kemi kry me ni fshat të serbëve se s'ka pasë vend në Lipjan për neve. U kanë objekt i shkollës fillore na e kemi kry shkollën e mesme pasdite. Gushtericë e Poshtme osht'. Janë tri fshatra etnikisht serbe ktu, ne lidhemi me qato tri fshatra.

Anita Susuri: Në gjuhën shqipe a serbe?

Halit Gashi: Shqip, shqip. Ajo u kanë pjesë e shkollës së mesme të Lipjanit. Edhe serbët kanë mësu në disa prej klasave. Ata kanë mësu serbisht na kemi mësu shqip. Jo, jo, jo fatmirësisht jo.

Anita Susuri: Si ka qenë ajo periudhë për juve?

Halit Gashi: Ka qenë periudhë e randë se edhe situata ekonomike nuk ka qenë e mirë edhe transporti nuk ka qenë i organizuar si duhet. Janjeva po vazhdon me pasë telashe për transport. Qysh kom pasë vështirësi une për me u shkollu për transport edhe fëmijët e mi po kanë vështirësi rreth transportit. Fatkeqësisht po vazhdon avazi historik prej të '90-ës deri në 2019-ën ka vështirësi të transportit Janjeva. Ka pasë autobusa po për pasdite kanë qenë pak ma të rrallë edhe tani numri i banorëve ka qenë i madh.

Anita Susuri: A ka ndodhë ndonjëherë që jeni mbetë pa transport? Si jeni kthy apo si jeni shku?

Halit Gashi: Po ka ndodhë shumë shpesh që kemi ardhë në kamë, ni orë, ni orë e dhjetë minuta kemi bo deri jemi ardhë në shtëpi po ka ndodhë shpesh...

Anita Susuri: Si kanë qenë ato rrugëtime?

Halit Gashi: Po ka pasë nifarë kënaqësie se jemi kanë bashkë, do të thotë prej klasës së parë deri kur e kemi kry vitin e dytë, domethanë deri në klasën e dhjetë të tashmen jemi kanë të njejtit njerëz. Qysh e kemi fillu... pastaj u kanë ni shoqëri e afërme shumë. E kemi... sidomos stinën e verës dhe të pranverës ka qenë një kënaqësi. Pak ma vështirësi kemi pasë dimrit kena mbetë najherë natën edhe

kish vështirësi, jo qenët jo, edhe të ri ishim. Por përgjithësisht, në pranverë edhe në verë e përjetojshim si kënaqësi.

Anita Susuri: E në atë kohën kur keni qenë i ri edhe ni moshë rinore, kemi dëgju që Janjeva ka qenë shumë e njohur për kafene, për jetën e natës. A keni qenë edhe ju pjesë e asaj?

Halit Gashi: Jo, jo, une asniherë, as para luftës as mbas luftës nuk jom kanë pjesë e jetës së natës. Nuk kam qenë, nuk... po ka pasë prej shqiptarëve që janë kanë pjesë e asaj. Për shembull, nëse në Janjevë ka qenë ni dyqan janë kanë nëntë kafene. Proporcioni ka qenë një me nantë. Ka pasë shumë kafene të vogla, po janë kanë shumë të frekuentume edhe të stërbushura prej... se ka pasë rini shumë. Po mendoj, çdo gja që kanë sjellë...

Dita e premte ka qenë ditë tregu në Janjevë. Mbahet edhe tash. Ka mbetë veç relikti i dikurshit. Ka një lloj tregu ni orë zgjatë pak qaty njerëzit sillen nga pak, mirëpo dita e premte ka qenë ditë feste në Janjevë. Edhe për shkak të xhumasë, po edhe për shkak të ditës së tregut që ka qenë. Të gjitha fshatrat përreth që kanë qenë... Janjeva, ta thom edhe ni fakt, deri në vitin 1954 e ka pasë statusin e komunës. Ka qenë me status të komunës. Dymbëdhjetë fshatra kanë gravitu në kuadër të Janjevës po prej '54-tës e ka hupë atë status. Ne kemi bo përpjekje mas luftës me ia kthy atë status po nuk ia kemi dalë, nuk deshti Ahtisaari me na bo komunë Janjevën.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: Na tregutë për ditën e pazarit. A mundeni me përshkru atmosferën si ka qenë në atë kohë?

Halit Gashi: Tash po duhet me rikthy pak kujtestën (qeshë). Ka qenë kënaqësi, e vërtetë ka qenë kënaqësi, gjallëri, njerëzit janë furnizu edhe prodhuesit edhe tregtarët. Përgjithësisht kanë qenë prodhues ata që i kanë sjellë prodhimet e veta prej fshatrave Banullë, Gllgovc, Slllovi, Smallushë. Nuk e kanë kthy mrapa asnjë, të gjitha i kanë shitë.

Anita Susuri: Çka u shitke?

Halit Gashi: Po perimet, qumështi e bylmeti. Prodhimet e qumështit të gjitha janë shitë...

Anita Susuri: A ka pasë edhe plastika?

Halit Gashi: E plastika janë kanë ato prodhimet e Janjevës. Ato janë shitë, ditën e tregut ato nuk janë shitë. Ato janë shitë nëpër vendbanime të tjera. Kudo që është bo ndonjë panair, qysh i kanë thanë ktyneherë, e ke pasë s'paku dhjetë-pesëmbëdhjetë përfaqësues të Janjevës, kudo në ish Jugovllavi. Jo veç në Kosovë po kudo në ish Jugosllavi.

Unë, për shembull, e kom shërby Shërbimin Ushtarak të Jugosllavië në nifarë ujëdhese u qujke Vis atje në Kroaci. Edhe atje ka pasë shqiptarë të Janjevës edhe kroat të Janjevës. Ishull që s'i kanë leju turistat me... po edhe në pikën e fundit të ish Jugosllavisë ka pasë janjevas. Po neve me na furnizu me bylmet e prodhimet pemë e perime na kanë furnizue, me pemë jo, pemtë i kena pasë. Mirëpo, perimet s'kanë mujtë me u bo për shkak të ujit, mungesës së ujit edhe tokës gurore. Me perime jena furnizu prej ktyne fshatrave përreth.

Anita Susuri: Ato kafene prej kujt kanë qenë ma së shumti të frekuentune?

Halit Gashi: Po prej kroatëve. Prej atyre që i kanë thanë vetës kroat. Pak ka pasë shqiptarë, pak ka pasë shqiptarë. Nja dy çajtove kanë qenë të shqiptarëve, pak ma të shmangta prej qendrës ku ishit. Ato krejt kanë qenë të kroatëve. Edhe ajo që jeni hi, emrin e ka pasë edhe ma herët "Bash Çarshi". Ky që e ka ble, ky shqiptari që e ka sot e ka trashëgu qat' emër, s'ia ka ndrru emrin e asaj kafenesë. Tjerat ia kanë ndrru të gjitha, po ajo e vetmja është që... unë nuk e mbaj në mend kur është bo kafe ajo.

Anita Susuri: Po ajo kafeneja, "Bash Çarshia", a ju kujtohet a ka qenë edhe kur keni qenë ju i vogël?

Halit Gashi: Po, po, po iu them. Pak ma ndryshe ka qenë, ky e ka renovu pak, blerësi i fundit, e ka renovu pak po une nuk e mbaj në mend kur është bo kafe ajo, do të thotë, unë e kom gjetë qashtu, kafe. Unë i kom 53 vjet, do të thotë, s'paku një gjysë shekulli ekziston si kafene ajo.

Anita Susuri: A mundeni pak me na përshkru se kemi dëgju që aty është këndu, është pi, është ngrënë?

Halit Gashi: Unë po iu them se Janjeva njihet si një vendbanim që për 800 vjet nuk ka pasë konflikte ndërnacionale edhe pse, sot hin ti me ni kafe edhe i ndëgjon njani flet turqisht, njani flet shqip, tjetri flet magjupisht, ose gjuhën rome, mos ta përdorim këtë, tjetri flet kroatisht, edhe nuk e din cili është shqiptarë cili është kroat, cili është, që deklarohet turk ose romë.

Edhe ka pasë jetë të natës Janjeva. Unë kom kalue, thashë që nuk e kom frekuentu po e kom mixhën pak ma naltë e kena pasë ni distancë, e kur jom shku te mixha tani kom kalu rreth qendrës. Aty s'paku kanë qenë njo dymbëshjetë, trembëdhjetë lokale në qat' qendrën e vogël. Dymbëshjetë, trembëdhjetë lokale plot, përherë kanë qenë plot edhe e kanë, ka vazhdu jeta deri në orët e vona, deri në mëngjes.

Sidomos festat kur i kanë pasë, Pashkët edhe Shëngjergjin. Shëngjergji i romëve, ata, romët e kanë bo gjithmonë atmosferë. Çdo ditë para Shëngjergjit ata e kanë fillu me muzikë, ka qenë gjallni. Tash, nuk ka, nuk ka festime të tilla.

Anita Susuri: E aty ni lokal që është afër kafesë "Bash Çarshia", a ka qenë i hapur kur jeni kanë ju ma i ri a i kujtoni ato?

Halit Gashi: Po, aty ka pasë, përballë "Bash Çarshisë"...

Anita Susuri: Po, 1928.

Halit Gashi: 28 shkrun ai lokal po ajo ka qenë kafene me këngëtare, me muzikë të gjallë edhe unë asnjëherë nuk kom hi mrena, po prej jashtit kom pa që mramje, sidomos për festa të ktyne, të kroatëve ka pasë muzikë të gjallë edhe është kriju atmosferë. Edhe kanë pasë të hyra prej atyne lokaleve se iu thashë që nëntë muj ditë janjevasit i kanë fitu jashtë Janjevës të hollat, po në Janjevë për tre muj ditë i kanë shpenzu. Qato tre muj ditë që s'kanë mujtë me punu dimrit i kanë shpenzu në Janjevë. Edhe të gjitha lokalet kanë pasë punë, jashtëzakonisht kanë pasë punë në Janjevë.

Anita Susuri: Në periudhën e shkollës së mesme çka ka ndodhë tjetër? Si ka vazhdu pastaj jeta juaj?

Halit Gashi: Unë jom, fatkeqësisht prej periudhës së shkollës së mesme deri kur e kom kry fakultetin ka qenë periudhë shumë e randë, jashtëzakonisht e randë. Kur e kom përfundu shkollën fillore ka qenë viti 1981 edhe në klasën e tetë kanë qenë demonstratat e vitit, prill edhe mars, mars e prill të vitit '81 ka qenë situatë jashtëzakonisht e randë. Pastaj, ne i vijonim mësimet në fshatin serb. Edhe pas '83-tës kur jena shku në Lipjan u dashke për çdo ditë me i kalu tri fshatra serbe që nuk kanë pasë disponim të mirë ndaj nesh, nuk kanë pasë. Ne nuk kemi pasë ndonjë konflikt të hapur po asnjëherë nuk kena ndejtë rahat me njani tjetrin. Çdo udhëtim që e kom marrë, kom dalë jashtë Janjevës pastaj kur e kom kry shkollën edhe fakultetin, une nanën teme, rahmet i pastë shpirti, e kom gjetë t'u m'pritë te dera se gjithë ka menu që do t'më ndodhë diçka gjatë rrugëtimit që i kaloj këto tri fshatra. Ka qenë periudhë e randë për neve janjevasit, Akllapin e Teqen. Ka qenë jetë jashtëzakonisht e randë.

Anita Susuri: A iu kujtohen juve demonstratat e vitit '81, a keni marrë pjesë?

Halit Gashi: Po, po, kom marrë pjesë. Na e kemi organizu ni demonstratë në Janjevë si të ri pa ndonjë vetëdije të plotë për çka po ndodhin.

Anita Susuri: Sa vjeçar keni qenë në atë kohë?

Halit Gashi: Unë kom qenë 15 vjeçar. Nuk muj tash unë me u lavdu se e kom bo me vetëdije të plotë, e kom bo se osh' dashtë me dalë. Iu kom bashkangjitë ni diçkaje që nuk kom mujtë me ditë cila është kauza. Tash, unë lehtë muj me thanë, valla jo e kom ditë, po nuk e kom ditë cila ka qenë kauza. Po, e kemi shënu si ditë. Ka qenë m' duket 4 ose 5 prilli kur në Janjevë është bo përpjekje për me u organizu ni demonstratë, e kanë mësu shpejt organet e policisë edhe organizatorët nuk më kujtohen kush kanë qenë po unë thjeshtë kam qenë si një pjesëmarrës.

Anita Susuri: A kanë marrë pjesë të gjithë apo...

Halit Gashi: Jo, pak, ka qenë numër i vogël. Jo kroatët, kroatët bile nuk kanë deshtë me ni për këtë punë, nuk kanë deshtë me ni për këtë punë.

Anita Susuri: Pas shkollës së mesme, a keni vazhdu menjëherë shkollimin e lartë ku...

Halit Gashi: Une, Fakultetin Juridik në Prishtinë. Po ni vjet si e kryshim shkollën e mesme na vinte thirja për me kry shërbimin ushtarak.

Anita Susuri: Si ka qenë ajo periudhë?

Halit Gashi: Edhe shërbimi ushtarak ka qenë jashtëzakonisht i randë. Mas demonstratave të '81-tës nuk kanë pasë, asnjëri prej kombeve që kem jetu në atë shtetin e Jugosllavisë nuk ka pasë bindje të mirë ndaj neve shqiptarëve se propaganda e ka bo të vetën. Pa na njoftë e kanë kriju një averzion ndaj nesh. Nuk na kanë njoftë po e kanë kriju averzionin. Kur s'i bon ni njerit diçka edhe e krijon averzionin veç e tregon ligshinë e vet, se na s'kishim kurgjo me sllovenët, s'kishim kurgjo me kroatët, s'kishim kurgjo me boshnjakët, po as me serbët nuk kishim kurgjo.

Ata vazhdimisht gjatë historisë janë mundu me na zhdukë prej tokës. Na nuk e kena atë ndjenjën që... se as s'ja kena falë jetën kërkujt, as s'e kem atë kompetencë me ia marrë kërkujt jetën. Mirëpo ka qenë e vështirë. Ka qenë e vështirë sidomos për gjeneratat pak ma të pjekura. Une kom qenë i ri edhe e kom përballu ma lehtë po njerëzit që kanë qenë 24-25 vjeçar... une e kom pasë një djalë të Preshevës, masi e kish kry fakultetin kish punu ni kohë në bibliotekën e shkollës, ai ka pasë vështirësi të jashtëzakonshme, e merrshin në biseda informative. Se neve të rinjëve s'kanë pasë çka me na marrë në biseda informative se tek e fundit nuk kem qenë ndonjë njerëz të mrrimë ose najfarë patrioti po përgjithësisht ka qenë vështirë.

Të gjithë ata kanë kalu, s'paku bile për qato 13 muj që i kemi shërby qasaj armate nja tri-katër herë secili prej nesh kemi qenë në biseda informative të sigurimit që kanë qenë biseda të randa, biseda, presion psikologjik i jashtëzakonshëm.

Anita Susuri: Fakultetin a e keni vazhdu në Prishtinë?

Halit Gashi: Po, në Prishtinë.

Anita Susuri: Si iu është dukë Prishtina atëherë?

Halit Gashi: Une, nëse e ndroj ndonjëherë vendbanimin me jetu dikund jashta Janjevës, ndoshta kisha jetu në Prishtinë. Janjevën nuk e ndroj me kërkond se historia e familjes time është e çuditshme. I pari jonë ka ardhë prej Prishtine në Janjevë u vendosë. Baba i babagjyshit tem ka ardhë në Janjevë. E ka pasë grujen e Janjevës edhe u ardhë në shtëpi të grusë edhe tani kemi mbetë në Janjevë.

Anita Susuri: Pse ka ardhë në shtëpi të grusë?

Halit Gashi: Ato kanë qenë nëntë motra pa vëlla edhe ka qenë vendosja e atyre pleqve që njëren prej bijave me pru në shtëpi. Edhe ai i pari jonë paska qenë ma i urti prej krejt dhondurve edhe ka ardhë prej Prishtinës me jetu në Janjevë. Edhe une tash kom qef veç në Prishtinë me shku, jo dikund tjetër. Janjeva... Prishtina, e kom kalu kohën ma të mirë edhe tash punoj në Prishtinë qe sa kohë.

E kom kalu pjesën ma të mirë të jetës time. Osht' mosha prej 20 vjeçar, osht' jeta ma e mirë kur njeri e ka jetën ma të mirë prej 20 deri në 40. E une qat' periudhë kohore e kom kalu në Prishtinë. Më lidhin shumë kujtime të mira, të jashtëzakonshme. Unë, për shembull, kom punu edhe në Lipjan njëmbëdhjetë vjet po me Lipjanin nuk më lidhë kurgjo, absolutisht kurgjo.

Anita Susuri: Si ka qenë në atë kohë Prishtina kur keni shku për herë të parë? Si ju është dokë?

Halit Gashi: Prishtina ka ndryshu shumë. Shumë ka ndryshu, fatkeqësisht shumë, jo për të mirë...

Anita Susuri: Çka ju kujtohet që ka ndryshu?

Halit Gashi: Prishtina ka qenë qytet i pastërt po p'e merr ka pak fizionominë. Ka pasë ndërtesa pak nuk ka pasë tollovi shumë. Qytet i qetë, përgjithësisht qytet i qetë. Gjallërinë ia jepshin studentat e të gjitha viseve që qysh ia jepin nxansat e shkollës së mesme Lipjanit gjallërinë... Lipjani tash kadal dale po bohet qytet i gjallë, mirëpo Prishtinës studentat edhe jeta kulturore.

Une e kom frekuentu teatrin shumë kur jom shku. Kënaqësi e jemja ka qenë me shku në teatër me i shiqu premierat. Sidomos u angazhojshim shumë për me siguru ni biletë për premierë, tani nuk ishte interesant që të përsëritjet me i pa. M'lidhen kujtimet e mira për Prishtinën veç që ka qenë qetësi. Ata aqë kanë dashtë me kriju, diçka me bo, diçka të mirë me i dhanë Kosovës kanë mujtë në Prishtinë me dhanë shumë sene.

Anita Susuri: Çfarë përshtypje iu kanë lanë ato premierat? Se thojnë që njerëzit janë pregaditë, domethanë në mënyrë speciale kur kanë shku në premierë.

Halit Gashi: Anitë, tash është vështirë se duhet me përjetu edhe me kallxu në qato momente. Ju e keni ma lehtë se na. Unë po iu them njerëzve Sabri Fejzullahu me djalë kur po knojnë, ju keni mundësi me regjistru çdo emocion, keni mundësi me regjistru çdo kujtim. Na, edhe qito fotografi i kemi rujtë me vështirësi. Po flasin mjaft edhe fotografitë, po ka pak... e meta, e meta e gjithë gjeneratës time, po them gjeneratës time, që nuk kemi shënue, nuk kemi mbajtë... unë për veti nuk kom mbajtë ndonjë ditar që i kish fresku ato emocionet. Se njeri kur lexon diçka edhe i kthehet në mend, por fatkeqësia që nuk kemi mbajtë shënime.

Anita Susuri: A keni udhëtu vazhdimisht në Janjevë kur keni qenë student?

Halit Gashi: Jo, jo. Veç vitin e parë kom udhëtu e viteve tjera kom banu. Nji vit kom banu në banesë private edhe dy vite kom banu në Qendër të Studentëve. Në Qendër të Studentëve ka qenë jetë e varfun po jetë e shkëlqyeshme, jetë shumë dinamike, jetë shumë e pëlqyeshme. Shoqni e jashtëzakonshme, e jashtëzakonshme. Ato...

Anita Susuri: Çka keni bo me shoqni ma shumë? A keni dalë?

Halit Gashi: Po kemi dalë. Na studentat e juridikut e kemi pasë ni përparësi që nuk na ka dashtë shumë me lexu, për me kry fakultetin nuk është dashtë shumë me lexu. Tash s’po lexojnë hiç, po na bile ni orë deri në dy orë e kena pasë të rezervune për me studiu, jo me lexu po me studiu. E vërtetë që kena studiu. Edhe kemi dalë shumë, kemi qenë ni grup i shokëve që kemi dalë.

Anita Susuri: Cilat vende i keni frekuentu?

Halit Gashi: Paj, përgjithësisht pak ka pasë vende. Na kemi dalë në Germi ma shumë. Ka pasë pak mundësi, lokale ka pasë pak, po qato i kemi shfrytëzu maksimalisht, maksimalisht i kemi ndrru çdo ditë dikund. “Arabeska” ka qenë e njohur për shkuarje, tash...

Anita Susuri: Ku ka qenë me vendndodhje?

Halit Gashi: Ajo ka qenë përballë New Born-it.

Anita Susuri: Në periudhën, domethanë të fakultetit. A jeni martu në qat’ periudhë apo keni fillu me punu? Kur keni fillu me punu? Na tregoni pak për atë periudhën pas fakultetit?

Halit Gashi: Mas fakultetit filloi pluralizmi në Kosovë. Unë kom diplomu në vitin ‘90 edhe u prish. Ndodhi në vitin ‘90, ndodhi greva e 3 shtatorit edhe u largun të gjithë të punësuarit që kanë qenë nëpër ndërmarrje shoqërore, në administratë. Edhe në koperative i largun njerëzit edhe ishte situatë jashtëzakonisht e randë. Pastaj unë jom ardhë. Prej atyre viteve unë kom fillu me politikë. Kam qenë shumë vjet në Lidhjen Demokratike...

Anita Susuri: Pas fakultetit menjëherë keni fillu?

Halit Gashi: Po, po, pas fakultetit menjëherë. Edhe nuk jom ndalë asnjëherë...

Anita Susuri: Si e keni marrë vendimin me u marrë me politikë?

Halit Gashi: Po spontanisht, jo me ndonjë përgaditje. Të them edhe një fakt për Janjevën. Në Janjevë ka pak kuadra të shkolluara, fatkeqësisht ka pak, shumë pak. Janjeva e Shtjefën Gjeçovit me pasë kaq pak kuadër? Unë jom ndër kuadrat e rralla. Edhe tash, e kisha jetën e bujshme në Prishtinë e vazhdova me të njejtin intenzitet. Edhe pse e kisha kry fakultetin, nuk kisha ku e shfrytëzoja atë përgaditje që e kisha marrë prej Fakultetit Juridik, u dashke me u marrë me diçka.

Edhe kjo... nuk e kom mendu asnjëherë mas 16 vjete që ka investu familja n’mu me kry fakultetin edhe me dalë me ni të ardhme që ka qenë e pasigurtë. Ndoshta e vetmja mundësi me u marrë me diçka ka qenë me u marrë me politikë të kohës, me organizimin e jetës plurale në Kosovë. Edhe në ‘93-tën kom fillu me punu si sekretar i shkollës ku e kom kry shkollën fillore. Deri në vitin 2000 kom punu si sekretar i shkollës po...

Anita Susuri: Ka qenë “Vladimir Nazor” apo...

Halit Gashi: “Shtjefën Gjeçovi”. Deri në të ‘90-ën ka qenë “Vladimir Nazor” pastaj... është rast karakteristik Janjeva, për shumë sene është karakteristike. *Sui generis* e quajnë këtë, *sui generis*, rast i veçantë, special. Në krejt Kosovën veç në Lipjan edhe në Janjevë i kanë ndalu edhe objektet shkollore edhe për filloren. Ne iu kena dhanë mësim nxansave edhe nëpër depo e... unë do të përpiqem me ia siguri ni kopje të asaj CD-së, m’doket që e ka qitë ai arsimtari i teknologjisë informative, ni xhirim që e kem bo në vitin ‘95. Ku janë ulë nxansat me marrë mësimin, ku i kemi shndërru odat në zyre. Zyrja e drejtorit edhe zyrja jeme kena pasë nifarë ode tri me tri, ni kauç edhe ni tavolinë edhe ni karrikë e kena pasë, e kena shfrytëzu si zyre.

Edhe ka qenë, kërkoi falje se harrova që jom para kamerës, se më shtine me u emocionu pak, ma rikujtove atë pjesën. Edhe është dashtë angazhim i jashtëzakonshëm për me organizu mësimin për nxanës. Nuk kem pasë banka, i kena improvizu edhe bankat. Unë s’kom qenë ndonjëfarë mjeshtri po kom punu në bërjen e ulësve për nxënës. S’kom ditë qysh m’i mshu teshlicës, ni gozhdë me e vnu, po më është dashtë me improvizu edhe me u bo mjeshtër i bankave. Se isha sekretar i shkollës u dashke me i bo përgaditjet. Në vitin e parë janë ulë në tulla edhe në blloka edhe në gajbe. E në vitin e dytë tani, në ‘95-tën i kemi bo tani do ulëse, i kemi improvizu. Na ka falë ni biznismen do drrasa edhe i kena improvizu ulëset.

Anita Susuri: Ku kanë qenë shpijat, ato ku janë mbajtë mësimet?

Halit Gashi: Qitu në lagjen tonë, në qit’ lagje pak ma poshtë.

Anita Susuri: Kanë qenë te rruga e “Sarajit” apo?

Halit Gashi: Po, po, në rrugë të “Sarajit” edhe në “Dardani”, në rrugë kryesore. Atëherë e ka pasë emrin “Nënë Tereza” e tash e ka “Dardania”. Se u dashke me i bo si afër, mos m’i shkepë nxansat edhe kur kanë dalë në pushim të gjatë nxansat pushimin e kanë bo në asfalt se s’ka pasë... objektet nuk kanë qenë me ni vend. Na u dashtë me i pasë pesë-gjashtë qasi depo për me i shndërru në klasë. Ka qenë rond.

E pasqyron mirë, e pasqyron atë dokumentarë, ai arsimtari i teknologjisë informative. Osht’ shumë i shkathtë, hala nuk ka dalë në pension, osht’ ni arsimtar i mirë në Lipjan, po jep mësim. Tash po ka suksese, i ka çu nxansat në gara në Amerikë, shkollën e Lipjanit, “Hajriz Rashiti”. Po e ka atë dokumentarin jashtëzakonisht të mirë që është histori e dokumentuar.

Edhe ni fakt tjetër që thuhet se ekzistojnë dokumente se shkolla e parë shqipe është hapë në Janjevë, në kuadër të kishës së Janjevës. Me ni urdhër françeskan është hapë shkolla që i ka pasë 13 nxansa që shqip kanë mësu në vitin 1625. Nuk ka dalë askush prej Akademisë së Shkencave dhe të Artit të Shqipnisë me demantu këtë të dhanë se në Janjevë është hapë shkolla e parë shqipe...

Anita Susuri: A është objekti afër kishës ajo shkollë apo ka qenë dikund tjetër?

Halit Gashi: Tash une nuk muj me te thanë a është kanë ai objekt, a u kanë ni objekt tjetër, se ai objekt është e vërtetë që edhe mas Luftës së Dytë Botërore është shfrytëzuar si shkollë. Motrat e mia që janë ma të vjetra se unë i kanë kry ka dy-tri klasë në qat' objekt që e keni pa ju, që dikur ka shërby si shkollë. Do të thotë edhe mas Luftës së Dytë Botërore i kanë kry ka dy-tri vjet shkollë në qat' objekt pastaj u bo qiky objekti i vjetër që e keni pa që është tu u rrënu, është lanë në mëshirën e fatit. Ky i riu është bo ma vonë.

Anita Susuri: E pse ka ndodhë ky ndryshimi i shkollës?

Halit Gashi: Për shkak të numrit të madh të nxansve. Shkolla e vjetër nuk ka pasë nyje sanitare mrena krejt i ka pasë jashtë edhe tani qytetarët e Janjevës kanë dhanë prej '81-tës në '89-tës pesë përqind të hyrave të familjes për me ndërtu shkollën. Kanë investu, e kanë kreditu shkollën, ndërtimin e shkollës së Janjevës me vet kontribut. Edhe qiky objekt i ri i shkollës është kontribut i janjevasëve, jo i shtetit. Po ne pesë përqind të hyrave të familjes, çdo familje i ka dhanë pesë përqind të hyrave mujore që i ka pasë për ndërtimin e objektit të shkollës...

Anita Susuri: Në kohën kur ju keni punu në shkollë, a ka qenë e vështirë me menaxhu, domethanë ka pasë edhe shqiptarë edhe kroatë edhe romë...

Halit Gashi: Jo, une kom punu veç në objekte jashta shkollës, fatkeqësia ime. Po, pasna punu pak prej korrikut '99-ës deri në dhjetor të 2000-tës. Po vitin e parë pas luftës, vitin e parë pas çlirimit kroatët hezituan nuk kanë ardhë në shkollë. Pastaj une në vitin 2000, në fund të vitit 2000 e kom lëshu arsimin, nuk iu kom kthy arsimin.

Kom punu përgjithësisht nëpër institucione të administratës edhe nuk e di atë ndjenjë qysh është me kanë me ni kulum ku janë arsimtarët serbë, nxanësit janë kroatë edhe shqiptarë edhe ka edhe arsimtarë edhe kroatë edhe shqiptarë. Nuk e di atë ndjenjë. Po për me u shkollu jom shkollu në qat' objekt ku ka pasë kroatë, romë, shqiptarë, turq që janë deklaruar. Po, mësimet i kom viju në qat' shkollë.

Anita Susuri: Ju jeni rritë ktu në Janjevë edhe domethanë ende vazhdoni me jetu. Si janë kto raportet ndërmjet njerëzve? A ka shoqëri?

Halit Gashi: Unë e thashë me një fjalë që për 800 vjet që e dijna që jetojna bashkarisht nuk dihet që ka pasë ndonjë konflikt. Janë vra vëllazërit me vëllazër ndoshta, por konflikte nuk ka pasë, as përkatësive tjera etnike nuk ka pasë asni konflikt individual as kolektiv. Normalisht që fëmijët janë shty ka pak me fjalë, ndonjë konflikt verbal edhe spontan ndonjë konflikt, po konflikt qysh ka pasë vrasje mes shqiptarëve për shkak të hakmarrjeve në Janjevë nuk ka pasë. As mes shqiptarëve mas mes tjerëve. Kapak ka pasë konflikte në Janjevë edhe s'ka. Fatmirësisht që është ru ajo.

Anita Susuri: Kur jeni martu ju?

Halit Gashi: Moti (qeshë). Jom martu në '93-tën, në shtatorin e '93-tës.

Anita Susuri: Si janë kto traditat e Janjevës? Traditat edhe të festave po edhe të dasmave.

Halit Gashi: T'thashë që përgaditjet për dasmë kanë fillu një vit përpara. Për shembull, edhe une kur jom martue, përgaditjet i kena fillu dy-tre muj ditë përpara. Jo sikur ata tjerët po... edhe dy-tri javë ditë për çdo natë në familjen time ka pasë muzikë. Kanë ardhë gjithë fqinjët prej pasditës deri në ortë e vona të natës ose në ortë e para të mëngjesit osht' bo muzikë. Kem pi çaj e ambëlsina, ka qenë atmosferë. Tri javë ditë ka qenë atmosferë.

Edhe me naj vështirësu na ka vështirësu se ka qenë karburanti shtrejtë, benzina edhe nafta ta qenë dy marka - tri marka qajo ka qenë vështirësi për xhepin tonë. Ne si punëtor të arsimit e kishim rrogën 50 marka e tash me pagu ni litër benzin tri marka katër marka... Po unë i falenderoj të gjithë ata që kanë ardhë janë bo dasmor. Janë bo njo 30 vetura kur unë... unë s'kam shku vet me marrë se s'ka qenë në kohën tonë. Kom gabu që s'kom shkue, une u dashtë me thy tabunë.

Ne jemi zgjedhë vet me nusën time. Edhe kanë shku 30 vetura në kohën kur ka qenë rond edhe flamuri kombëtar u kanë në veturën e parë. Kanë pasë probleme me serbët e ktuhit për shkak të flamurit, po fatmirësisht në dasmën time nuk ka ndodhë asni problem.

Anita Susuri: E si jeni taku me bashkëshorten?

Halit Gashi: Jemi taku në Prishtinë, e kom njoftë pak motrën e saj ajo ka studiu në Gjilan edhe jemi taku rastësisht nëpërmjet ni shokut të përbashkët edhe ka fillu lidhja.

Anita Susuri: A ka studiu edhe bashkëshortja ju?

Halit Gashi: Jo, nuk ka studiu, nuk ka studiu. E ka kry shkollën e mesme në të '90-ën kur u prish sistemi, i gjithë sistemi. Nuk ka studiu nusja.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: A ka pasë traditë të veçantë, domethanë kroatët a kanë pasë tradita të veçanta të dasmave edhe të festave prej shqiptarëve...

Halit Gashi: Po, po i kanë pasë po. Osht' ni karakteristikë që ma vërteton atë konstatimin tem që ata janë shqiptarë. Në veshjen e kroatëve të Kroacisë nuk bojnë pjesë dimitë edhe mitanet, iu thojnë mitane. Kanë ngjashmëri të madhe me veshjen kombëtare tonën. Ata që i thojnë vetit, që e njohin vetën për kroat, nuset e tyre janë veshë me dimija me mitane. Edhe punë dore kanë qenë ato, i rujnë ato hale i kanë edhe...

Anita Susuri: A kanë dalë ashtu me veshje nëpër rrugë?

Halit Gashi: Po, po, po, po.

Anita Susuri: A keni dalë nëpër rrugë me i pa?

Halit Gashi: Po, po, po. Ka qenë atmosferë. Ata e kanë bo kurorëzimin në kishë edhe të gjithë dasmorët kanë shku me e përcjellë çiftin në kishë, janë enë nëpër Janjevë me muzikë të gjallë, kanë shpërnda bonbona, kanë shpërnda amëlsina, kanë shpërnda pije. Ka qenë atmosferë e jashtëzakonshme. Edhe ata kanë bo atmosferë për dasma, i kanë ru traditat.

Janë vendosë në dy vendbanime. Ngat Zagrebit quhet ni vendbanim Dubravë që janë vendosë përgjithësisht kroatët e Janjevës edhe ni katun që ka qenë i serbëve në Komunën e Kninit, Kistanje i thojnë. Ata që s'kanë pasë kushte materiale për me maru shtëpia janë vendosë në shtëpitë e kroatëve në Kistanje. Edhe atje po i rujkan traditat e ktuhit po nuk po shihen bash me sy të mirë traditat e kroatëve të Janjevës se nuk janë tradita autoktone të kroatëve po janë tradita që (qeshë), janë tradita të shqiptarëve. Edhe janë thirrë mes veti nëpër dasma, janë thirrë.

Anita Susuri: A iu kujtohet juve ajo periudha e viteve të '90-a kur kanë fillu me u shpërngulë ata?

Halit Gashi: Po, po, po.

Anita Susuri: Si ka qenë?

Halit Gashi: Ata kanë qenë për me përshpejtue shkuarjen e kroatëve prej Janjevës, e atyre që janë deklaruar si kroat. Përpos vështirësive ekonomike që u krijun shumë vështirësi ekonomike kanë qenë edhe shkaqet politike. Njëri prej tyre që u vra ushtar ka qenë edhe njëri prej, i përkatësisë kroate, qitu në lagjen tonë...

Anita Susuri: Ku është vra ai?

Halit Gashi: Është vra në Maqedoni e u kthy në arkivol e tani e ka përshpejtu shumë shpërnguljen e atyre që janë deklaruar në kroat. Llogaritet se Janjeva i ka pasë dikund rreth 500-600 shtëpi të kroatëve e tash nuk i ka as 30-40 që janë të banueshme. I kanë ble do shqiptarë që, edhe të besimit musliman edhe të besimit katolik i kanë ble shtëpitë e tyre. Se është ni katun Brus edhe Peshtesh atje në komunë të Lipjanit, po janë pak ma naltë, ata janë përgjithësisht katolik. Të besimit katolik, po shqiptarë janë. Krejt janë Gashë me mbiemër edhe të besimit katolik edhe musliman janë me mbiemër Gashi. Ata janë, kanë zbritë shumica kanë zbritë në Janjevë edhe i kanë ble shtëpiat e kroatëve, po pak ka që i kanë ble shtëpiat e kroatëve. Shtëpiat e kroatëve janë në rrënim e sipër, sidomos ato të vjetrat janë në rrënim e sipër.

Anita Susuri: Si ka qenë ajo koha kur kanë shku ata...

Halit Gashi: E dhimbshme.

Anita Susuri: Na kanë përmend kamionët e kto nëpër rrugë.

Halit Gashi: Jo, jo. Ata kanë shku individualisht nuk kanë shku në mënyrë të organizuar, por për shembull, çdo të dytën ditë, të tretën ditë ka shku ni familje. Edhe jo kshtu, me kamiona të organizun nuk ka pasë. Shpërngulje të organizune, do të thotë, me shku dhjetë familje përneherë nuk ka pasë po kanë shku tek tuk, çdo dy ditë ka njo, tri ditë e... Mirëpo e randë, situata e randë.

Anita Susuri: Si e keni përjetu ju?

Halit Gashi: Na e kena përjetu dyfish ma rond se ata. Se gjeneratat e babës tem edhe pak ma të vjetër e kanë përjetue qysh është me lëshu vendin. Për shembull, pjestë e familjes time kanë shku në Turqi. Kusherit e babës tim kanë shku në Turqi që na shkojmë ndonjëherë i vizitojmë baba, rahmet i pastë shpirti, nuk ka pasë mundësi me shku asniherë. E baba im edhe baba i atij e kanë përjetu dyfish rond. Fatmirësisht që baba s'ka qenë gjallë me pa këtë shpërnguljen e kroatëve, po e ka pa shpërnguljen e kusherive të vet edhe mixhallarëve të vet kur kanë marrë rrugë për Turki.

Anita Susuri: Ju a keni pasë miq ose dikond që u shpërngulë prej kroatëve?

Halit Gashi: Prej kroatëve unë nuk kom pasë, pak shoqni me ta. Vëllau im është shoqnu pak ma shumë me ta, unë pak jom shoqnu për shkak të shkollimit që kom pasë edhe nuk kom pasë shumë shoqni. Thjeshtë e kom pasë një shok që ka shku për prift në shkollë, takohemi herë pas here. Ai jeton dikund në Itali, ai kroati, familja e tij jeton në Kroaci, po kem pasë shoqni të mirë.

Unë e kom përjetu rond shkuarjen e tij për në shkollën për prift se e kom pasë shok të mirë. Po tjerët sigurisht i kanë pasë, e kanë pasë shoqinë pak ma të zgjerume. Ka ndiku shumë edhe në ekonomi edhe në raportet ndërnjerëzore edhe në shoqni ka ndiku shumë shpërngulja. Ka qenë jetë e gjallë edhe kanë kriju të hyra ata. Kanë punu, kanë qenë popull punëtor. Atje p'e shoh që nuk janë sikur kur kanë qenë në Janjevë, jo si në Janjevë. Janë bo barrë e shtetit në asistencë sociale.

Anita Susuri: Si ka vazhdu zhvillimi i juj me politikën pas viteve të '90-ta?

Halit Gashi: Unë, të gjitha zhvillimet që kanë ndodhë për 20 vjet në Komunën e Lipjanit, prej të 90-ës deri në të 2000-tën kam qenë pjesë e zhvillimeve. Po edhe dhjetë vjet mas, deri në 2010-ën kom qenë shumë aktiv në politikë. Prej 2013-ës e kom pauzu me marrjen me politikë. Megjithatë prej '90-ës deri '99-ën e kena pasë ni motiv shtesë. Se kena qenë të robëruar nuk ka qenë ndonjë politikë e mirëfilltë po ka qenë, nëpërmjet politikës me bo diçka mirë për kombin, me bo diçka mirë, me hjekë zgjedhën e hujë prej Kosovës.

Ka qenë një ndjenjë pak ma ndryshe, ma e vullnetshme, ma solidare. E kjo pas vitit '99, 2000-tës ka qenë e përzier edhe ndjenja e shtetndërimimit edhe ndjenja e harlisjes tonë mas materiales, shumë mas materiales, jemi dhanë shumë mas materiales. Ishalla Zoti na ndihmon e na kthen në rrugë të mbarë, se shumë jemi dhanë mas materiales, që po them. Shumë pak kena bo për pjesën kulturore.

Ne po arsyetohemi që na kanë pengu ndërkombëtarët me bo sene të mira. Ndërkombëtarët asni ndikim nuk e kanë pasë për me bo arsimin e mirë, me bo kulturën e mirë. Na kem pasë jetë kulturore. Me bo shëndetësinë e mirë. Kto tri shtylla që është dashtë me i bo mirë nuk i kena bo mirë. Pjesë e politikës kom qenë edhe une dhe e ndjej pjesën e përgjegjësishë për ato punë që s'i kena bo të mira.

Anita Susuri: A iu kujtohet periudha e luftës? Si ka qenë?

Halit Gashi: Sigurisht që më kujtohet se kom qenë në moshën ma të mirë kur...

Anita Susuri: A keni qenë në Janjevë?

Halit Gashi: Po, në Janjevë vazhdimisht kom qenë. Janjeva, nuk është largu askush prej Janjevës. Na kem pasë mysafirë shumë prej pjesëve të tjera të komunës së Lipjanit, përgjithësisht të komunës së Lipjanit, pjesës lindore, Vërshevc e deri në Krojmir e Shalë kanë ardhë. Ka pak njerëz, jo shumë po ata që kanë mujtë me depërtu kanë ardhë edhe në Janjevë. Jemi mundu që t'i mirëpresim me atë që kem pasë na edhe ka pak me ia largu atë ndjenjën e lënies së shtëpisë. Ata kanë lanë krejt çka kanë pasë të gjallë edhe jemi mundu, jo me u krekos, po jemi mundu me ra në nivelin e tyre edhe me bashkëbisedu. Me mujtë që me ia harru, bile së paku sa kanë qenë afër nesh. Me bashkëjetu me dhimbjen e tyre.

Anita Susuri: A iu ka ndihmu edhe komuniteti kroat?

Halit Gashi: Nuk kanë guxu, nuk kanë guxu. Me na pengu s'na kanë pengu. Ndhma ma e madhe që nuk na kanë pengu shumë. Nuk na kanë pengu shumë. Ka raste individuale që kanë ndihmu, ka raste individuale, po janë pak.

Anita Susuri: A keni përjetu ndonjë ngjarje ma të randë gjatë luftës apo diçka?

Halit Gashi: Personalisht nuk kom përjetu diçka, po ni fqiju i jonë, ni, osht' vra. E ka Janjeva një viktimitë. Ai ka dalë me ni fshat afër i thohet Shashkovc, ai është fshat me komunën e Prishtinës po është afër Janjevës, dy kilometra s'i ka. Edhe ka shkue, ka qenë fshati i tij, ai ka lind në atë fshat po dikur me ni periudhë ka ardhë me jetu Janjevë edhe u dalë me pa shtëpijen e vëllaut a ia kanë djegë edhe ushtarët e kanë gju prej largit edhe e kanë vra. Ka qenë situatë e randë atë ditë që është vra ai.

Ajo ka qenë... pastaj ka pasë ka pak... një oficer u ardhë disa i ka malltretu, disa qytetarë. Thuhet se ka vdekë në komunikacion ai eprori ushtarak ka qenë i ushtrisë jugosllave, ushtrisë serbe se s'ka pasë ushtri jugosllave. Ka psu aksident dikun, po ai ka bo malltetime te qytetarët e Janjevës. Përgjithësisht edhe shqiptarët edhe romët, kroatët nuk e di nëse ka bo ndonjë. Janjevën e kanë ru si nifarë çerdhe të vetën se tonë ditën kanë zhvillu luftime edhe në mramje kanë ardhë nëpër ato kafet që i kanë pasë kroatët kanë pi raki edhe kanë hangër mish, që kroatët janë detyru me shërby. Shqiptarët nuk kanë pasë kafe në atë kohë.

Anita Susuri: Në periudhën e pas luftës, si keni vazhdu ju? Çka keni vazhdu?

Halit Gashi: Unë kom vazhdu me bo për shkollën, përgjithësisht jom mundu me pru nivelin e duhur. Ia kemi arritë me fitu ni donacion me përfundu shkollën e re që ka fillu me kontribut. Me fitu projektet, pastaj kom marrë përgjegjësiën edhe në komunë. I kom pasë disa pozicione, me përgjegjësi në komunë edhe jom mundu me...

Anita Susuri: Komunën e Lipjanit apo?

Halit Gashi: Komunën e Lipjanit. Po, po Komunën e Lipjanit.

Anita Susuri: A ka qenë e vështirë ajo periudhë edhe si e keni përjetu ju?

Halit Gashi: Me pasë përgjegjësi edhe mos me pasë mundësi me ndihmu kur fshatra të tëra kanë qenë të djegura edhe kërkesat kanë qenë të jashtëzakonshme edhe mundësia e ndihmës ka qenë e kufizuar. Buxheti komunal ka qenë shumë i vogël. Ka pasë donatorë që herë na kanë dëgju herë s'na kanë dëgju, herë e kanë keqpërdorë ato ndihma. Po jemi mundu me aq sa kem pasë kaqik, me një fjalë të mirë mos me kthy kërkond se ka qenë situatë e randë, ku njerëzit kanë hupë çdo gja të gjallë që kanë kriju për shumë vite, kanë hupë për mrena ditës. Kanë hupë ma të dashurit, ajo që e ka ngarku situatën, po dashti Zoti e kemi tejkalu pa ndonjë traumë të madhe. Njihemi edhe gjatë historisë që njerëzit që e rikthejnë situatën shpejt, e marrin vetën shpejt, si popull e kena marrë vetën shpejt në krahasim me qysh kemi qenë. Ka qenë rondë me menaxhu me institucione në atë kohë.

Anita Susuri: Si ka vazhdu pastaj aktiviteti juj politik?

Halit Gashi: Pastaj pas 2001-2004 ka qenë periudhë e randë, e pas 2004-tës kur ndodhën ngjarjet e 2004-tës edhe ato na dhanë ni goditje. Zhvillimit të Kosovës iu dha ni goditje. Ngjarjet e 2004-tës, marsit të 2004-tës kanë lanë një kujtim të keq për mu. Jo veç për mu, po përgjithësisht ata që e kanë përjetu situatën e 2004-tës ka qenë ni luftë, një mini revolucion që ka ndodhë.

Anita Susuri: Ku keni punu ju atëherë në atë kohë?

Halit Gashi: Në komunë kom qenë. Hala nuk ka dalë dikush me ndonjë të dhanë se kush e organizoi. Ajo vetëvetiu nuk ka ndodhë. Ka qenë periudhë shumë e randë, shumë e randë që përgjithësisht kanë psu ma shumë shqiptarët se dikush tjetër. Të kish qenë organizim i shqiptarëve... unë po dyshoj që ka qenë, dyshimet e mia. Unë nuk muj me thanë që është definitive, po dyshimet më qojnë që nuk ka qenë organizim i shqiptarëve. Se të kish qenë organizim i shqiptarëve nuk ishin vra shqiptarët. Mos të hyjmë në kospiracione tash.

Anita Susuri: Si ka vazhdu pastaj? Keni fillu me punu edhe në Prishtinë...

Halit Gashi: Po une kur e përfundova mandatin në Lipjan kom shku kom punu në nivelin qendror një tri vite e jom rikthy edhe niherë. Tri vitet në Prishtinë kanë qenë të mira, kom punu me ni autoritet që është kriju së pari, një autoritet i telekomunikacionit. Kom qenë përgjegjës për telefoninë mobile. Një institucion shumë i respektuar, por që përgjithësisht shqiptarët nuk dijnë me kriju institucione të mira.

Kena dështu edhe në atë institucion që ka qenë mundësia me bo institucion të mirë. Na nuk e kena bo as ata, s'e kena bo mirë. Pastaj kom punu në Ministrinë e Administratës Publike nja shtatë muj. Jom kthy në 2007-ën përsëri në Lipjan. Për nja gjashtë vjet jom kanë në Komunë të Lipjanit. Prej 2016-ës punoj në Kuvend të Kosovës edhe mendoj me u penzionu me qat' punë që e kam.

Anita Susuri: Me çka merreni tash? Çka punoni?

Halit Gashi: Unë jom pjesë e njësisë që e mbështetë kryesinë e kuvendit edhe seancat. I përgadisim skenaret, proces-verbalet, vendimet. Krejt çka merren vendimet... ato që i shihni që i lexon kryetari i kuvendit ose kryesuesi i kuvendit, cilido që udhëheqë është pjesë e njësitit tonë. Ne jepim këshillat juridike, këshillat ligjore se si duhet të aprovohet ni projektligj, të bohet ligj ni iniciativë, të gjitha janë pjesë e atij njësi.

Anita Susuri: A është punë e vështirë?

Halit Gashi: Jo, nuk është punë e vështirë është punë profesionale që e kom gjetë vetën mirë aty.

Anita Susuri: Me çka, për shembull, ma shumë... çka ia kushtoni ma së shumti kohës në këtë periudhë tani? Me çka merreni ma shumë? A është vetëm puna si diçka qendrore me të cilën merreni apo keni edhe ndonjë tjetër hobi ose diçka?

Halit Gashi: Une deri vitin e kalum kom lu basketboll me fmitë e mi edhe me shoqni. Vitin e kalum e kom lanë pak basketbollin. E kom pasion basketbollin. Kurdo që kom mundësi ka pak me kopsht mirrna në shtëpi mas orarit të punës. Kom menu që kur të afrohem ka penzioni me i bo do bletë e me u marrë me bletë. Nëse kom ymer, që thuhet.

Anita Susuri: Mbasi u lidhëm te sporti dashta me iu pytë, e di që ma herët Janjeva ka pasë edhe, domethanë, sporti ka qenë i zhvillim në Janjevë. A iu kujtohen kto?

Halit Gashi: Po, Janjeva i ka pasë dy klube me za. E ka pasë klubin e futbollit që e ka financu Fabrika e Metallcit, ka qenë ni fabrikë e verigave metalike, qityne bravave të derës edhe ka qenë ni fabrikë shumë profitabile para luftës në Janjevë. Edhe pagat i kanë pasë të mira. I ka pasë dikund rreth 600-700 punëtor, përgjithësisht kanë qenë të Janjevës edhe të komunës së Lipjanit. Të hyrat kanë qenë të mira për punëtorin. Edhe e ka financu edhe sportin. Dy klube thashë, e përmenda klubi i futbollit që ka mrrri deri në ligën e dytë të Kosovës edhe klubi i volejbollit ka funksionu. Se përgjithësisht na nuk kena pasë edhe vende të mira ku me shpreh talentin tonë. E kem pasë ni oborr të shkollës që ka qenë i pasur me dhe ashtu kanë lujt volejboll edhe ni fushë të futbollit për mizerje. Po, megjithatë në ato kushte është zhvillu nji jetë...

Anita Susuri: Aty i kanë bo ato stërvitjet apo...

Halit Gashi: Po, qaty qaty i kanë bo stërviçjet, po megjithatë përkundër kushteve të këjja rezultatet nuk kanë mungu. Edhe financimin tani e kanë bo ka pak, e ka financu Fabrika e Metallcit që ka pasë mundësi me financu kto dyjat edhe klubin e volejbollit edhe të futbollit.

Anita Susuri: A keni shku ju nëpër kto ndjeshjet? A i keni përcjellë?

Halit Gashi: Po, po, ktu në Janjevë, po e ma larg nuk jemi shku se...

Anita Susuri: A kanë shku shumë njerëz?

Halit Gashi: Po kanë shku, kanë shku. Përgjithësisht kur janë shku nëpër vendbanimet serbe nuk kanë kalu mirë, janë përleshë me serbët. Serbët i kanë sulmu edhe kroatët jo veç shqiptarët, po edhe kroatët.

Anita Susuri: Tash ju keni fëmijë edhe vazhdoni jetën ktu në Janjevë. A shkollohen ata ktu apo...

Halit Gashi: Po, vajza e madhe ka diplomu në gjuhën angleze në Universitetin e Prishtinës, vajza e dytë është duke studiuar në Turqi, vajza e tretë studion letërsinë turke edhe djali studion edukatën fizike.

Anita Susuri: A jetojnë ata ktu apo...

Halit Gashi: Po, po ktu jetojnë. Vajza...

Anita Susuri: A kanë në Janjevë diçka përspektivë për të rinjtë?

Halit Gashi: Jo, jo.

Anita Susuri: Pse?

Halit Gashi: Po përgjithësisht se është jetë e randë. Veç me bo gjumin në Janjevë është mirë.

Anita Susuri: Pse? Çka ka ndryshu?

Halit Gashi: Po mundësia e krijimit të mirave materiale është ngushtu. Me ni vend ku nuk ka ujësjellës qysh jetojnë disa familje, une kisha ikë natën, jo ditën, po natën kisha ikë. Jetojnë në kushte jashtëzakonisht të randa. Bajne ujë me kuaj, presin deri t'i mushin ato kavanozat, dy-tri orë deri t'i mushin. Është jetë e randë, është jetë e randë. Edhe mundësia e nxjerrjes së jetesës për familje është vështirësu. Tash s'je që mirresh as me bujqësi as me ndonjë zejtar, të gjitha kanë ra poshtë. Me punu me naj objekt hotelier 150 euro deri në 200 euro në mujtë, çka me bo ai që punon as vetën s'mun me majtë me to. Prandaj, është goxha e vështirë me jetu në Janjevë për shkak të kushteve të randa materiale.

Anita Susuri: Dashta edhe me iu pytë për kto festat që vijnë kta janjevasit, domethanë kroatët. Si bohet atmosfera kur të vijnë ata?

Halit Gashi: Deri pak para disa vitesh, para katër-pesë vitesh, ka pasë atmosferë tash u zbeh shumë, shumë u zbeh. Ka nisë për shkak të kushteve të randa edhe ata që i kanë në Kroaci, për shembull 2003-tën u festu 700 vjetori i ardhjes së kroatëve. Ka qenë ni festë e jashtëzakonshme, ka pasë shumë mysafirë. U shënu 700 vjetori kur në libra kishtarë njihet që ka ardhë kroati i parë në Janjevë në kohën e Republikës së Dubrovnikut. Edhe e financoi shteti kroat. Ka qenë ni manifestim i mirë.

Anita Susuri: A keni qenë edhe ju aty?

Halit Gashi: Po, po kam qenë.

Anita Susuri: Si keni kalu?

Halit Gashi: Mirë, mirë, përgjithësisht mirë. Ka qenë mysafir i ndjeri Bajram Rexhepi në atë kohë ka qenë Kryeministër i Kosovës. Ka pasë pjesëmarrës, shumë ka pasë pjesëmarrës edhe kanë ardhë edhe prej Kroacisë. U pat' kriju ni atmosferë po...

Anita Susuri: Çka ka qenë e veçantë për atë ditë?

Halit Gashi: E veçanta se njerëzit pas shumë viteve iu kanë kthy Janjevës. Ka pasë njerëz që, për shembull kur u shpërngul në të '90-at deri në 2003-tën s'ka ardhë. Kur ka ardhë mas 13 vjetve në Janjevë ajo ndjenja që i ka taku njerëzit që i ka njoftë dikur, qysh kanë ndryshu njerëzit për 13 vite, 14 vite, kanë ndryshu shumë. Edhe... mos p'e preki mikrofonin?

Anita Susuri: Jo, jo, mirë është.

Halit Gashi: Edhe ndjenja që janë bo njerëzit bashkë. E meta e atij organizimi se e ka personalizuar shumë prifti. Prifti është i gjeneratës time, nja dy vjet ka qenë në shkollë para meje. Ai shkollën fillore e ka kry në Janjevë pastaj shkollën e mesme kishtarë edhe fakultetin e ka kry jashtë Kosovës, në Kroaci edhe Itali po më duket. Edhe është një person që i personalizon shumë çështjet. Çdo gjë që bëhet në Janjevë don me lidhë me punën e vet. Qajo ka qenë e meta e atij organizimi se e ka personalizuar shumë. Edhe e meta tjetër është që me pasë pasë vullnetin e mirë Janjevën e kish rikthy. E kish rikthy me zhvillim me investime, po ai nuk ka dashtë që investimet të bohen në Janjevë. Nuk e di pse po i kanë penguar shumë investimet.

Anita Susuri: Për fund a keni edhe diçka që kishit shtu ose që keni harru me përmend?

Halit Gashi: Une përgjithësisht po flas kshtu ndoshta edhe kom harru shumë sene pa thanë, po për momentin nuk po më kujtohet diçka që duhet me shtu.

Anita Susuri: Mirë, faleminderit shumë.

Halit Gashi: Faleminderit edhe prej juve.